Rezultati për identifikimin e përbërësve të lidhësit bazë dhe rezultati për vlerën e peshës specifike duhet të jenë provuar me anë të metodës së testimit në përputhje me Standartin Shqiptar SSH EN 12802:2011 “*Materiale për vijëzimet horizontale në rrugë - Metodat laboratorike për identifikim*” ose ekuivalentin e tij.

**11. ASTAR PËR SIPËRFAQE DYSHEMEJE OSE BETONI**

Astar sintetik (epoksid) për sipërfaqe të jashtme, i cili të hollohet me ujë dhe të jetë në gjendje për të konsoliduar lidhjen midis shtresave të ndryshme si gips, çimento, suva, beton etj. dhe shtresës së bojës. Të jetë i lehtë në aplikim dhe të ketë normë të lartë përhapje.

**Karakteristikat Teknike:**

- Natyra e lidhësit: Kopolimer (rezinë) epokside
- Forca e ngjitjes:  $\geq 2.5 \text{ N/mm}^2$
- Tharja për rilyerje:  $\leq 6$  orë
- Norma e hapjes:  $\geq 8 \text{ m}^2/\text{litër}$
- Pesha specifike:  $1 \pm 0.1 \text{ kg/litër}$
- Pamja estetike: Transparente ose me ngjyrë
- Magazinimi: Në temperatura në intervalin  $+10^\circ\text{C}$  deri në  $+30^\circ\text{C}$
- Jetëgjatësia: jo më pak 1 (një) vit nga lëvrimi
- Hollimi me ujë:  $\geq 10\% - 20\%$
- Paketimi: Në kova plastike ose metalike 1-15 litra

**STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:**

- Përmbajtja e VOC (përbërësit organikë të paqëndrueshëm):  $\leq 30 \text{ g/l}$  e provuar sipas Standartit Shqiptar SSH EN ISO 11890-2:2020 Bojra dhe llaqe - Përcaktimi i përmbajtjes së përbërjeve organike të avullueshme (VOC) dhe/ose përbërjeve organike gjysmë të avullueshme (SVOC) - Pjesa 2: Metoda gazkromatografike ose ekuivalentin e tij.
- Standartin Shqiptar SSH EN 13813:2004 Materiali për shtrimin e dyshemesë dhe shtresat e dyshemesë - Materiali për shtrimin e dyshemesë - Vetitë dhe kërkesat ose ekuivalentin e tij.

**12. LLAK PËR PARKET DRURI SPORTIV.**

Llak poliuretani vetë - lidhës, me bazë uji. Ky produkt duhet të ketë vetë të mira mekanike dhe rezistencë të lartë ndaj detergjentëve larës, të arrijë në një kohë sa më optimale një ngurtësi të lartë të sipërfaqes me rezistencë të lartë ndaj gërryerjeve. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm për lyerjen e parketeve të drurit në palestra, duke pasur një koeficient rrëshkitshmërie sa më të ulët. Të jetë i gatshëm për përdorim.

**Karakteristikat teknike:**

- Natyra e lidhësit: Polimer poliuretani
- Tharja për rilyerje:  $\leq 5$  orë
- Norma e hapjes:  $\geq 12 \text{ m}^2 / \text{litër}$
- Pesha specifike:  $1.1 \pm 0.2 \text{ kg/litër}$
- Pamja estetike: mat, me shkëlqim, gjysëm me shkëlqim, natyrale
- Ngjyrat në dispozicion: transparente ose të ndryshme sipas katalogut
- Temperatura e aplikimit:  $+5^\circ\text{C} - +30^\circ\text{C}$
- Magazinimi: Në temperatura në intervalin  $+5^\circ\text{C} - +30^\circ\text{C}$
- Paketimi: Në kova plastike ose metalike 1-5 Litra
- Jetëgjatësia: jo më pak se 1 (një) vit nga lëvrimi

**STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:**

Standartin Shqiptar SSH EN 14904:2006 lidhur me sipërfaqet e brendshme të ambienteve sportive ose ekuivalentin e tij.

### 13. ASTAR PËR PARKET DRURI SPORTIV.

Ky produkt duhet të jetë i përshtatshëm për t'u aplikuar në dyshemetë sportive prej druri dhe aplikohet para aplikimit të llakut. Duhet të hollohet me ujë dhe të jetë i përshtatshëm për aplikim në sipërfaqe të mëdha. Të ketë një punueshmëri të lartë dhe lehtësi në zmerilim duke mbajtur të pandryshuar ngjyrën origjinale të drurit të zmeriluar.

#### Karakteristikat teknike:

|                            |                                                |
|----------------------------|------------------------------------------------|
| - Natyra e lidhësit:       | Polimer poliuretani                            |
| - Tharja për rilyerje:     | ≤ 2 orë                                        |
| - Norma e hapjes:          | ≥ 10 m <sup>2</sup> / litër                    |
| - Hollimi:                 | 10-15% me ujë                                  |
| - Pesha specifike:         | 1.1 ± 0.2 kg/litër                             |
| - Pamja estetike:          | mat, me shkëlqim, gjysëm me shkëlqim, natyrale |
| - Ngjyrat në dispozicion:  | transparent                                    |
| - Temperatura e aplikimit: | + 5°C - +30°C                                  |
| - Magazinimi:              | Në temperatura në intervalin + 5°C - +30°C     |
| - Paketimi:                | Në kova plastike ose metalike 1-5 Litra        |
| - Jetëgjatësia:            | Jo më pak se 1 (një) vit nga lëvrimi           |

### 14. BOJË KUNDRA MYKUT

Bojë emulsioni e përshtatshme për lyerjen e sipërfaqeve të brendshme në zona me lagështi të lartë dhe kondensim avulli si kuzhina, banjo, tavane dhe bodrume. Kjo bojë duhet të parandalojë rritjen e kërpudhave (si myku etj.) sipas standardit EN 15457. Duhet të ketë shkallë mbulimi të lartë, shkallë të lartë përhapjeje dhe bardhësi superiore. Duhet të ketë veti shumë të mira niveluese dhe të prodhojë një sipërfaqe të lëmuar dhe të sheshtë. Mund të aplikohet në sipërfaqe të ndryshme.

#### Karakteristikat teknike:

|                           |                                                    |
|---------------------------|----------------------------------------------------|
| - Natyra e lidhësit:      | Emulsion anti myk                                  |
| - Viskoziteti:            | 100 ± 20 KU (Krebs-Stormer method) ose ekuivalente |
| - Tharja për rilyerje:    | ≤ 5 orë                                            |
| - Norma e hapjes:         | ≥ 5 m <sup>2</sup> /litër me dy shtresa            |
| - Pesha specifike:        | 1.5 ± 0.2 kg/litër                                 |
| - Hollimi:                | 10-15% me ujë                                      |
| - Pamja estetike:         | E lëmuar, mat, pa shkëlqim                         |
| - Ngjyrat në dispozicion: | E bardhë ose të ndryshme sipas katalogut           |
| - Magazinimi:             | Në temperatura në intervalin + 5°C - 30°C          |
| - Jetëgjatësia:           | jo më pak se 1 (një) vit nga lëvrimi               |
| - Paketimi:               | Në kova plastike ose metalike 1-15 litra           |

#### STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

- Eficienca ndaj mykut duhet të jetë e provuar sipas Standartit Shqiptar SSH EN 15457:2014 Bojra dhe llaqe - Metoda laboratorike për testimin e efikasitetit të konservantëve membranor në veshjet kundër sporeve që prodhojnë organizma ose ekuivalentin e tij.

### 15. BOJË AEROSOL PËR PIKTURAT MURALE.

Bojë spray për përdorim në sipërfaqet murale. Të jetë me përbërje nitro alkide, me mbulueshmëri të lartë, për çdo sipërfaqe, të brendshme apo të jashtme, me ngjitje dhe tharje të shpejtë. Të jetë rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe rrezeve UV. Të jetë me përmbajtje të lartë pigmenti, dhe me një gamë ngjyrash mbi 200 nuanca. Valvolat e aplikimit të jenë cilësore dhe të përshtatshme për ndërrimin e kokave të këmbyeshme. Gjatë përdorimit të mos pikoje dhe të mos krijojë pluhurizim jashtë diapazonit të sprucimit. Temperatura e përdorimit të variojë minimalisht nga -10°C deri në +50°C. Të jetë në paketim metalik aerosol me volum 400 ml - 600 ml.

### 16. PIGMENTE PËR NGJYROSJE

Pigmente me bazë uji për ngjyrosjen e bojrave me bazë vinilike për ambientet e brendshme.

**Karakteristikat Teknike:**

| NGJYRA<br>23°C | VISKOZITETI                              | PH      | DENSITETI NE                |
|----------------|------------------------------------------|---------|-----------------------------|
| E ZEË          | 1400 - 3100 cPs (ose ekuivalente)        | 5.5-9,5 | 1.60-1.80 g/cm <sup>3</sup> |
| E KUQE         | 1400 - 3100 cPs (ose ekuivalente)        | 5.5-9.5 | 1.80-2.20 g/cm <sup>3</sup> |
| E VERDHË       | 270 - 1600 cPs (ose ekuivalente)         | 5.0-9.0 | 1.00-1.20g/cm <sup>3</sup>  |
| JESHILE        | 270 - 1600 cPs (ose ekuivalente)         | 5.5-9,5 | 1.20-1.40g/cm <sup>3</sup>  |
| BLU            | 1400 - 2600 cPs (ose ekuivalente)        | 7.0-9,5 | 1.80-2.00 g/cm <sup>3</sup> |
| LEJLA          | 100 - 1100 cPs (ose ekuivalente)         | 6,0-9,0 | 1.00-1.20 g/cm <sup>3</sup> |
| KAFE           | 270 - 1600 cpS (ose ekuivalente)         | 6.0-9.0 | 1.50-1.70gcm <sup>3</sup>   |
| PËRDORIMI:     | për bojërat me bazë vinilike             |         |                             |
| PAKETIMI:      | Kuti plastike ose metalike 0.5 - 2 Litra |         |                             |
| JETËGJATËSIA:  | jo më pak se 1 (një) vit nga lëvrimi     |         |                             |
| MAGAZINIMI:    | +5° - +30°                               |         |                             |

**17. STUKO PATINIMI**

Stukoja e patinimit të jetë material pluhur, i bardhë, të jetë i përgatitur në formë pluhuri me bazë çimento, pluhur mermeri, rezina dhe aditiv . Të realizojë një veshje plastike (akrilike) për sipërfaqe të ndryshme të mureve, me efekt mbushës dhe maskues duke krijuar një shtresë të trashë, e cila mbulon dëmtimet e mundshme të shkaktuara në sipërfaqet e mureve dhe njëkohësisht e mbron nga agjentet atmosferikë.

**Karakteristikat teknike:**

- Konsumi:  $\leq 1\text{kg/m}^2/1\text{ mm}$  shtresë
- Raporti i përzierjes: 2-3 litra ujë për 10 kg produkt të thatë
- Rezistenca në ngjeshje:  $\geq 5\text{ MPa (N/mm}^2\text{)}$
- Rezistenca në përkulje:  $\geq 1.5\text{ MPa (N/mm}^2\text{)}$
- Forca në ngjitje:  $\geq 0.8\text{ MPa (N/mm}^2\text{)}$
- Ngjyrat në dispozicion: E bardhë ose të ndryshme sipas katalogut
- Magazinimi: Në temperatura në intervalin + 5°C - 30°C
- Jetëgjatësia: jo më pak se 1 (një) vit nga lëvrimi
- Paketimi: në thasë letre ose të plastifikuar 10-30 kg

**STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:**

- Standartin Shqiptar SSH EN 998-1:2016 ose ekuivalentin e tij. Ky standart është i zbatueshëm për llaçet e fabrikuara të suvatimit dhe stukimit, të bëra në bazë të lidhjeve inorganike për përdorim të jashtëm (prodhuës) dhe të brendshëm (suatim) në mure, tavane, kolona dhe ndarëse. Ai përmban përkufizime dhe kërkesa përfundimtare të performancës së produktit.

**18. LLAÇ I GATSHËM**

Llaçi i gatshëm të jetë i prodhuar për aplikim si material mbushës për mure tulle ose blloqe betoni, për ambiente të brendshme ose të jashtme, dhe të jetë i përgatitur në formë pluhuri me bazë çimento, gëlqere, rërë guri, rezina sintetike dhe aditiv. Duhet të ketë cilësinë që të aplikohet kur temperatura e ambientit të jetë jo më pak se +5°C - +35°C.

**Karakteristikat teknike:**

- Pesha specifike:  $2 \pm 0.2\text{ kg/litër}$
- Raporti i përzierjes: 2-3 litra ujë për 10 kg produkt të thatë
- Rezistenca në përkulje:  $\geq 1.5\text{ MPa (N/mm}^2\text{)}$
- Rezistenca në ngjeshje:  $\geq 4.5\text{ MPa (N/mm}^2\text{)}$
- Forca në ngjitje:  $\geq 0.8\text{ MPa (N/mm}^2\text{)}$
- Fillimi i ngurtësimit: 360-400 min
- Magazinimi: Në temperatura në intervalin +5°C - +30°C në ambient të thatë

- Jetëgjatësia: jo më pak se 1 (një) vit nga lëvrimi
- Paketimi: në thasë letre ose të plastifikuar 10-30 kg

**STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:**

- Standartin Shqiptar SSH EN 998-1:2016 ose ekuivalentin e tij. Ky standart është i zbatueshëm për llaçet e fabrikuara të suvatimit dhe stukimit, të bëra në bazë të lidhjeve inorganike për përdorim të jashtëm (prodhues) dhe të brendshëm (suvatim) në mure, tavane, kolona dhe ndarëse. Ai përmban përkufizime dhe kërkesa përfundimtare të performancës së produktit.

**19. HIDROIZOLUES**

Material dykomponentesh me bazë çimento dhe hidroizolues, elastik me funksion mbrojtës për tarracë, themele, bodrume, tualete etj. Duke përzier të dy komponentet përfitohet një masë që aplikohet në sipërfaqet të cilat duhet të hidroizolohen. Aplikimi i materialit bëhet me furçë ose mallë me disa duar.

**Karakteristikat teknike:**

- Natyra e lidhësit: Komponenti A (pluhur) + Komponenti B (lëng).
- Pesha specifike: 1.4 - 1.6 kg/litër (komp A) dhe 1 - 1.2 kg/litër (komp B)
- Raporti i përzierjes:  $\approx 3$  kg komp A + 1 litër komp B
- Konsumi teorik: 3-4 kg /m<sup>2</sup>/ 1 mm shtresë
- Djegshmëria: i padjegshëm
- Temperatura e punueshmërisë: në intervalin + 5°C - +30°C
- Magazinimi: Në temperatura në intervalin + 5°C - +30°C në ambient të thatë
- Jetëgjatësia: jo më pak se 1 (një) vit nga lëvrimi
- Paketimi: Komponenti A në thasë letre ose të plastifikuar 20 - 30 kg  
+ Komponenti B në bidon plastik ose metalik 5 – 10 kg

**STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:**

- Standartin Shqiptar SSH EN 14891:2017 ose ekuivalentin e tij. Produkte të lëngshme të papërshkueshme nga uji për përdorim nën tjegulla qeramike të ngjitura me lëndë ngjitëse - Kërkesat, metodat e provës, vlerësimi dhe verifikimi i qëndrueshmërisë së performancës, klasifikimi dhe markimi.

**20. Tretës (hollues) dylent nitro.** Hollues pa ngjyrë, për bojëra me bazë solventi. Të shërbejë për hollimin e produkteve me bazë solventi dhe si pastrues për pajisjet e aplikimit. Të ketë shkallë të lartë e avullimi për të mundur përmirësimin e aplikimit. Paketimi në konfesion metalik 1- 5 litra.

**21. Rula standart komplet për përdorim profesional për lyerje,** me bojëra plastike, akrilike dhe hidromat. Gjatësia 200 mm - 250 mm. Materiali përbërës i fijeve të jetë sintetik/mikrofibër/poliamid/ natyral. Gjatësia e fijeve  $\geq 20$  mm. Diametri i rulit të jetë  $\Phi 50\text{mm} \pm 5\text{mm}$ . Bishti të jetë metalik me dorezë plastike dhe të jetë i përshtatur për montim në zgjatues (kodar).

**22. Rula të vegjël komplet për përdorim profesional për lyerje.** me bojëra plastike, akrilike dhe hidromat. Gjatësia 100-160 mm. Materiali përbërës i fijeve të jetë sintetik/mikrofibër/poliamid /natyral. Gjatësia e fijeve  $\geq 5$  mm, diametri i rulit të jetë  $\Phi 15\text{mm} \pm 2\text{mm}$ . Bishti të jetë me gjatësi 250-300mm, metalik me dorezë plastike dhe të jetë i përshtatur për montim në zgjatues (kodar).

**23. Mbajtëse boje për rula të vegjël.** Mbajtëse boje plastike e përshtatshme për përdorime të ndryshme duke e bërë lyerjen më cilësore dhe të jetë shumë e lehtë për t'u pastruar. Të jetë prodhuar me formë kompakte dhe ndërtuar nga materiale të cilësisë së lartë. Të jetë ideale për lyerjen e sipërfaqeve me bojë me bazë uji dhe bojë vaji. Cilindri i rulit duhet të shtrihet plotësisht në sipërfaqen e mbajtëses, duke mundur aplikim të bojës në sipërfaqe të lëmuar dhe sipërfaqe të ashpër. Forma gjeometrike e mbajtëses së bojës duhet të krijojë mundësinë për shpërhapje të mirë dhe të njëtrajtshme të bojës sipërfaqen e cilindrit të rulit. Përmasat: Gjerësia 130mm - 160mm, Gjatësia: 250mm - 300mm.

**24. Kodar zgjatues 3 metra** për bishtat e furçave dhe rrulave. Të jetë i ndërtuar nga material alumini dhe projektuar për t'i rezistuar kohës dhe punëve intensive dhe i përshtatshëm për zgjatimin

---

e veglave të lyerjes dhe arritjes së sipërfaqeve me vështirësi të lartë aksesit. Me gjatësi prej 3m, lehtëson punën gjatë lyerjes në ambiente me lartësi të mesme. Të jetë i qëndrueshëm në zgjatje dhe minimalisht të ketë 2 (dy) hapje me diametër të bazës jo më pak se 20mm.

**25. Kodar zgjatues 5 metra** për bishtat e furçave dhe rrulave. Të jetë i ndërtuar nga material alumini dhe projektuar për të rezistuar kohës dhe punëve intensive dhe i përshtatshëm për zgjatimin e veglave të lyerjes dhe arritjes së sipërfaqeve me vështirësi të lartë aksesit. Me gjatësi prej 5m, lehtëson punën gjatë lyerjes në ambiente me lartësi të mëdha. Të jetë i qëndrueshëm në zgjatje dhe minimalisht të ketë 4 (katër) hapje me diametër të bazës jo më pak se 30mm.

**26. Furçë për lyerje me kënd** për përdorim për të gjitha llojet e bojërave. Të realizojë prerjet e këndeve në sipërfaqet e lyerjes. Fijet të jenë me densitet të lartë dhe material natyral ose sintetik i cilësisë së lartë. Dimensionet: gjerësia 60-80mm, trashësia 15-20mm. Të jetë e pajisur me mekanizëm fiksues për rregullimin e këndit deri në 180° kurse bishti të jetë plastik dhe i përshtatshëm për montimin me zgjatues (kodar).

**27. Furçë për lyerje me përdorim për të gjitha llojet e bojërave.** Të jenë të përshtatshme për profesionistët dhe të përdoret për aplikime të zakonshme apo të veçanta. Furça të jetë e përshtatshme për lyerje sipërfaqesh muri, druri dhe metali dhe aplikimin e llaveve për lyerjen e sipërfaqeve të mureve ose metalike. Fijet të jenë me densitet të lartë dhe material natyral ose sintetik i cilësisë së lartë kurse bishti të jetë plastik ose druri. Dimensionet: gjerësia 50-60mm, trashësia 10-15mm.

**28. Furçë e madhe për lyerje me përdorim për bojëra me bazë uji.** Furça të jetë e përbërë nga fije sintetike ose natyrale me densitet të lartë dhe të jetë ideale për lyerje të sipërfaqeve të mëdha dhe bishti të jetë plastik ose druri. Dimensionet: gjerësia 170-200mm, trashësia 70-100mm.

**29. Spatola patinimi të mëdha,** për riparimin apo rregullimin e sipërfaqeve të ndryshme në mure, dyshe apo sipërfaqe të tjera. Të jetë një dorezë të rehatshme dhe një teh fleksibël prej inoksi i cili bën të mundur arritjen e rezultateve të kënaqshme në punë. Doreza të jetë e ndërtuar prej druri ose plastikë rezistente. Të ketë një strukturë fleksible dhe solide. Gjerësia 160- 180mm.

**30. Spatola patinimi të vogla,** për riparimin apo rregullimin e sipërfaqeve të ndryshme në mure, dyshe apo sipërfaqe të tjera. Të jetë një dorezë të rehatshme dhe një teh fleksibël prej inoksi i cili bën të mundur arritjen e rezultateve të kënaqshme në punë. Doreza të jetë e ndërtuar prej druri ose plastikë rezistente. Të ketë një strukturë fleksible dhe solide. Gjerësia 100-120mm.

**31. Shirit ngjitës maskimi (tenie).** Shirit letre ngjitës për maskimin e cepave për qëllime të ndryshme. Të ketë një fushë të gjerë aplikimi dhe të jetë e përshtatshme për maskime gjatë lyerjes. Ngjitësi të ketë aftësi të mira ngjitëse në mur, të jetë lehtësisht i përdorshëm në zona me harqe dhe mos të lejë shenja gjatë heqjes. Gjerësia 20-30mm. Gjatësia 30-50m, trashësia (spesori): 120-160 µm.

**32. Qese mbulimi.** Të jetë një plasmas mbulimi për të mbrojtur mobiljet gjatë procesit të lyerjes në ambiente të brendshme dhe të jashtme. Të jetë i përshtatshëm për të mbuluar mobiljet, dyert dhe dritaret gjatë lyerjes. Të ketë cilësi të lartë për të evituar grisjen dhe çarjen dhe të jetë lehtësisht i përdorshëm. Të jetë e përbërë prej materiali LDPE (polietilen me densitet të ulët) në formë drejtkëndore me sipërfaqe jo më të vogël se 20m<sup>2</sup>, me trashësi (spesori): ≥ 10 µm.

**33. Koka sprucimi të këmbyeshme për aerosolet.** Të jenë të përshtatshme për montim në aerosolin e ofruar (produkti nr.12 në tabelën e Shtojcës 6). Të jenë të ndërtuara nga material plastik cilësor dhe lehtësisht të montueshme tek valvola e aerosolit. Seti të përbëhet nga minimumi tre koka të këmbyeshme, me diapazon sprucimi: **1)** 5 - 20 mm, **2)** 10 - 30 mm, **3)** 40 - 60 mm.

**34. Penel për piktura murale 76 mm.** Të jetë i përshtatshëm për profesionistët dhe të përdoret për piktura murale të bojërave akrilike. Fijet të jenë me densitet të lartë dhe material natyral ose sintetik i cilësisë së lartë kurse bishti të jetë druri. Dimensionet: gjerësia 76 ± 2mm, gjatësia e qimeve të jetë 40-50 mm. Gjatësia e totale e penelit të jetë 220-260 mm.

---

**35. Penel për piktura murale 36 mm.** Të jetë i përshtashëm për profesionistët dhe të përdoret për piktura murale të bojrave akrilike. Fijet të jenë me densitet të lartë dhe material natyral ose sintetik i cilësisë së lartë kurse bishti të jetë druri. Dimensionet: gjerësia  $36 \pm 2\text{mm}$ , gjatësia e qimeve të jetë  $40 \pm 2\text{mm}$ . Gjatësia totale e penelit të jetë 320-360 mm.

**36. Penel për piktura murale 16 mm.** Të jetë i përshtashëm për profesionistët dhe të përdoret për piktura murale të bojrave akrilike. Fijet të jenë me densitet të lartë dhe material natyral ose sintetik i cilësisë së lartë kurse bishti të jetë druri. Dimensionet: gjerësia  $16 \pm 1\text{mm}$ , gjatësia e qimeve të jetë  $22 \pm 2\text{mm}$ . Gjatësia totale e penelit të jetë 280-320 mm.

**37. Penel për piktura murale 14 mm.** Të jetë i përshtashëm për profesionistët dhe të përdoret për piktura murale të bojrave akrilike. Fijet të jenë me densitet të lartë dhe material natyral ose sintetik i cilësisë së lartë kurse bishti të jetë druri. Dimensionet: gjerësia  $14 \pm 1\text{mm}$ , gjatësia e qimeve të jetë  $20 \pm 2\text{mm}$ . Gjatësia totale e penelit të jetë 280-320 mm.

**38. Penel për piktura murale 12 mm.** Të jetë i përshtashëm për profesionistët dhe të përdoret për piktura murale të bojrave akrilike. Fijet të jenë me densitet të lartë dhe material natyral ose sintetik i cilësisë së lartë kurse bishti të jetë druri. Dimensionet: gjerësia  $12 \pm 1\text{mm}$ , gjatësia e qimeve të jetë  $18 \pm 2\text{mm}$ . Gjatësia totale e penelit të jetë 280-320 mm.

**39. Penel për piktura murale 10 mm.** Të jetë i përshtashëm për profesionistët dhe të përdoret për piktura murale të bojrave akrilike. Fijet të jenë me densitet të lartë dhe material natyral ose sintetik i cilësisë së lartë kurse bishti të jetë druri. Dimensionet: gjerësia  $10 \pm 1\text{mm}$ , gjatësia e qimeve të jetë  $16 \pm 2\text{mm}$ . Gjatësia totale e penelit të jetë 280-320 mm.

**40. Shënjes për grafitë 20mm.** Marker (shënjes) me bazë alkoli për përdorim në sipërfaqje të thjeshta. Për përdorim në sipërfaqe të brendshme dhe përdorim të kufizuar jashtë. Tharje e shpejtë.

**41. Shënjes për grafitë 8mm.** Marker (shënjes) me bazë alkoli për përdorim në sipërfaqje të thjeshta. Për përdorim në sipërfaqe të brendshme dhe përdorim të kufizuar jashtë. Tharje e shpejtë.

**42. Rimbushës për shënjesit e grafitëve 250ml.** Është një produkt që përdoret për të mbushur markerët (shënjesit) që përdoren për shënime në sipërfaqe të ndryshme.

### **Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

Mallrat do të lëvrohen të shoqëruara me garancitë përkatëse (të përcaktuara në DST dhe ne kontrate) në marrëveshjen e përcaktimit të kushteve të garancisë, para lidhjes së kontratës do të definohen dhe mënyrat, koha, dhe çdo specifikim tjetër i vlefshëm dhe i detyrueshëm për palët kontraktuese. Përzgjedhja e specifikimeve teknike të bojërave është bërë duke u bazuar tek standarti i bojërave të ofruara sipas kontratave të mëparshme gjatë viteve dhe nevojave reale të institucionit për llojin, sasinë dhe cilësinë e bojërave duke patur parasysh se këto bojëra përdoren në ambiente shkollore dhe parashkollore ku patjetër duhet të përmbushen standartet teknike të cilësisë dhe të ndikimit në mjedis.

Përcaktimi i specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi është bazuar në publikimet e prodhuesve të ndryshëm në faqe web, standartet teknike të cilësisë të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit në bazë të Ligjit nr.9870, datë 04.02.2008 “Për standardizimin” (i ndryshuar), kontratat e mëparshme të ngjashme dhe komunikimit me specialistët e drejtorisë sipas natyrës së punës që ata kryejnë në lidhje me materialet objekt prokurimi.

Materialet që kërkojmë të furnizohemi do të përdoren për mirëmbajtjen dhe lyerjen dhe riparimin e ambienteve të shkollave, kopshteve, çerdheve etj. Prandaj ato duhet të jenë ekologjike, cilësore dhe të padëmshme për shëndetin e fëmijëve.



---

Në bazë të rregullave të vendosura nga Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.907, datë 21.12.2016 *“Për kufizimin e shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa bojëra, llaqe dhe produkte për lustrimin e mjeteve”*, këto produkte duhet të:

- kenë përmbajtje sa më të ulët të përbërësve organikë të avullueshëm (të çlirojnë sa më pak të jetë e mundur)
- pigmentet të jenë në përputhje me kriteret ekologjike.
- të mos përmbajnë metale të rënda apo substanca toksike.

Bojrat e përdorura për lyerje të ambienteve të brendshme dhe të jashtme përmbajnë kimikate, të cilët deri më së fundmi janë të rëndësishme për cilësinë dhe karakteristikat e bojës. Ato ndihmojnë në lidhjen e komponenteve, në qëndrueshmërinë dhe në normën e përhapjes së saj. Këto kimikate, të tilla si amoniaku apo solvente të avullueshëm, të quajtur VOCs, kur boja thahet avullojnë, çlirohen nga cipa e tharë e bojës dhe qëndrojnë në ajrin e ambientit të lyer. Ato janë potencialisht të dëmshme, pasi personat që popullojnë këto ambiente thithin ajrin e ngopur me këto avuj. Ato shkaktojnë simptoma akute, duke përfshirë dhimbje koke, të vjella, probleme në rrugët e frymëmarrjes, alergji, etj .

Përmbajtja e VOCs në bojra dhe materialet e tjera për lyerje për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm, është e rregulluar nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.907, datë 21.12.2016 *“Për kufizimin e shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa bojëra, llaqe dhe produkte për lustrimin e mjeteve”*. Ky Vendim, përshkruan limitin e emetimit të përbërësve organikë të avullueshëm nga bojërat. Ky legjislacion detyron prodhuesit e bojërave të prodhojnë produkte që të garantojnë cilësi për ajrin e ambienteve të brendshëm dhe të jashtëm. Dhe për këtë ato duhet të testojnë produktet e tyre, nga laboratorë të certifikuar, që tregojnë përmbushjen e këtyre kufizimeve në lidhje me limitimin e emetimit të VOCs në ajrin e brendshëm dhe të jashtëm të ambienteve. Sipas këtyre kriterëve të përcaktuara nga ky vendim do të ishte e nevojshme që produktet e ofruara të vërtetonin përmbushjen e këtyre kriterëve me anë të raporteve të testimit të kryera nga laboratorë të certifikuar.

Testimet duhet të kryhen sipas standartit SSH ISO 11890-2 ose ekuivalentit të tij për monitorimin e nivelit të çlirimit të VOCs në ajrin e ambientit të brendshëm dhe të jashtëm për produktet bojëra dhe llaqe dhe komponentëve ndihmës si astari etj. do të na ndihmojë të vlerësojmë për cilësinë e tyre dhe përmbushjen e normave të kërkuara. Veçanërisht boja plastike duhet të ketë performancë të mirë, të ketë normë të lartë përhapje dhe të jetë pa erë.

Për shkak të përdorimit të bojës plastike në ambiente kopshtesh, çerdhesh dhe shkollash, ku higjena duhet të jetë e lartë, duhet që boja plastike të jetë e lashme dhe të ketë aftësi të mira për pastrimin e saj. Prandaj produkti duhet të shoqërohet me certifikatë/raport testimi, nga një ent certifikues i akredituar, që ai plotëson Standartet Teknike Shqiptare SSH EN ISO 11998:2006 lidhur me rezistencën në fërkim të lagësht dhe aftësia për t'u pastruar e veshjeve/shtresave të holla të lyerjes, SSH EN ISO 6504-3:2007, lidhur me aftësinë mbuluese (fshehëse) të bojës ose ekuivalentët e tyre dhe standarte të tjera teknike sipas produktit të kërkuar.

Për sa i përket kriterëve teknike të aftësisë së shtrirjes së bojës, ato janë të përcaktuara në nivel teorik pasi në praktikë kjo ndryshon nga shumë faktorë të cilat ndikojnë në normën e sipërfaqes së mbulimit siç janë; poroziteti, ashpërsia, parregullsia, aftësia e përthithjes së materialit e sipërfaqeve që do të lyhen, mënyra e aplikimit të bojës dhe destinacioni për të cilën do të përdoret. Këto përcaktime janë në pothuaj të gjitha web-sitet zyrtarë të

operatorëve ekonomikë prodhues botërorë ku përcaktohet i njëjti qëndrim për standartin e parashikimit të aftësisë mbuluese të bojërave.

Mallrat do të lëvrohen të shoqëruara me garancitë përkatëse (të përcaktuara në DST dhe në kontratë) në marrëveshjen e përcaktimit të kushteve të garancisë, para lidhjes së kontratës do të definohen dhe mënyrat, koha, dhe çdo specifikim tjetër i vlefshëm dhe i detyrueshëm për palët kontraktuese. Të gjitha mallrat të cilat do të lëvrohen nga operatori ekonomik fitues duhet të jenë patjetër konform ofertës teknike të ofruar dhe të depozituar duke përfshirë cilësitë teknike dhe markën e prodhuesit. Të gjitha paketimet e mallrave objekt prokurimi duhet të jenë të etiketuara në gjuhën shqipe referuar nenit 8 të Ligjit nr.9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve".

Furnizimi do të bëhet me mjetet teknike të furnizuesit në magazinat e autoritetit kontraktor sipas kërkesës të Autoritetit Kontraktor në sasi, lloj dhe kohë brenda afatit të përcaktuar në çdo minikontratë të lidhur nga data e nënshkrimit. Lloji dhe sasia e mallrave objekt prokurimi që do të furnizohen do të përcaktohen qartë nga Autoritetit Kontraktor dhe do të vihet në dispozicion të operatorit ekonomik fitues ditën e nënshkrimit të çdo minikontrate.

Bazuar në sa më sipër grafiku i lëvrimit do të jetë: Furnizimi do të bëhet nga nënshkrimi i kontratës deri më 12 (dymbëdhjetë) muaj pas nënshkrimit të kontratës sipas llojit, sasisë së mallit dhe kushteve të lëvrimit të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

#### **Shtojca 7.**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### **FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

#### **Sasia e mallit që kërkohet:**

| <b>Nr.</b> | <b>Pershkrimi I mallrave</b> | <b>Njesia</b> | <b>Sasia</b> | <b>Afati i lëvrimit</b> |
|------------|------------------------------|---------------|--------------|-------------------------|
| 1          | Boje fasade akrilike         | kg            | 12,700       | 12 muaj                 |
| 2          | Astar akrilik                | kg            | 2,900        | 12 muaj                 |
| 3          | Boje plastike                | kg            | 38,500       | 12 muaj                 |
| 4          | Astar plastik                | kg            | 4,800        | 12 muaj                 |
| 5          | Boje hidromat                | kg            | 19,500       | 12 muaj                 |
| 6          | Boje per dru dhe metal       | kg            | 700          | 12 muaj                 |
| 7          | Astar antikorroziv           | kg            | 400          | 12 muaj                 |
| 8          | Boje betoni                  | kg            | 500          | 12 muaj                 |
| 9          | Boje per siperfaqe sportive  | kg            | 1,400        | 12 muaj                 |
| 10         | Boje bikomponente vijezi     | kg            | 150          | 12 muaj                 |
| 11         | Astar per dysHEME dhe beton  | kg            | 400          | 12 muaj                 |
| 12         | Llak per parket druri        | litra         | 200          | 12 muaj                 |

|    |                                              |       |        |         |
|----|----------------------------------------------|-------|--------|---------|
| 13 | Astar per parket druri sportiv               | litra | 200    | 12 muaj |
| 14 | Boje kundra mykut                            | kg    | 2,000  | 12 muaj |
| 15 | Boje aerosol per piktura murale              | litra | 1,000  | 12 muaj |
| 16 | Pigmente per ngjyrosje                       | kg    | 1,200  | 12 muaj |
| 17 | Stuko Patinimi                               | kg    | 6,300  | 12 muaj |
| 18 | Llac I gatshem                               | kg    | 12,000 | 12 muaj |
| 19 | Hidroizolues                                 | kg    | 2,350  | 12 muaj |
| 20 | Tretes ( hollues ) dylent nitro              | litra | 750    | 12 muaj |
| 21 | Rula standart komplet per lyerje             | cope  | 600    | 12 muaj |
| 22 | Rula te vegjel komplet per lyerje            | cope  | 300    | 12 muaj |
| 23 | Mbajtese boje per rula te vegjel             | cope  | 40     | 12 muaj |
| 24 | Zgjatues (kodar) 3 metra                     | cope  | 140    | 12 muaj |
| 25 | Zgjatues (kodar) 5 metra                     | cope  | 90     | 12 muaj |
| 26 | Furce per lyeje me kend                      | cope  | 300    | 12 muaj |
| 27 | Furce per lyerje                             | cope  | 300    | 12 muaj |
| 28 | Furce e madhe per lyerje                     | cope  | 150    | 12 muaj |
| 29 | Spatola patinimi te medha                    | cope  | 70     | 12 muaj |
| 30 | Spatola patinimi te vogla                    | cope  | 70     | 12 muaj |
| 31 | Shirit ngjites maskimi ( tenie )             | cope  | 1,200  | 12 muaj |
| 32 | Qese mbulimi                                 | cope  | 900    | 12 muaj |
| 33 | Koka sprucimi per aerosol                    | set   | 450    | 12 muaj |
| 34 | Penel per piktura murale 76 mm               | cope  | 80     | 12 muaj |
| 35 | Penel per piktura murale 36 mm               | cope  | 80     | 12 muaj |
| 36 | Penel per piktura murale 16 mm               | cope  | 150    | 12 muaj |
| 37 | Penel per piktura murale 14 mm               | cope  | 150    | 12 muaj |
| 38 | Penel per piktura murale 12 mm               | cope  | 150    | 12 muaj |
| 39 | Penel per piktura murale 10 mm               | cope  | 150    | 12 muaj |
| 40 | Shenjues per grafite 20 mm                   | cope  | 120    | 12 muaj |
| 41 | Shenjues per grafite 8 mm                    | cope  | 120    | 12 muaj |
| 42 | Rimbushes per shenjuesit e grafiteve 2500 ml | cope  | 100    | 12 muaj |

| Nr. | Përshkrimi i mallrave       | Njësia | Sasia  | Cmimi per njesi (Lekë pa Tvsh) | Vlera gjithsej (Lekë pa Tvsh) |
|-----|-----------------------------|--------|--------|--------------------------------|-------------------------------|
| 1   | Boje fasade akrilike        | kg     | 12,700 |                                |                               |
| 2   | Astar akrilik               | kg     | 2,900  |                                |                               |
| 3   | Boje plastike               | kg     | 38,500 |                                |                               |
| 4   | Astar plastic               | kg     | 4,800  |                                |                               |
| 5   | Boje hidromat               | kg     | 19,500 |                                |                               |
| 6   | Boje per dru dhe metal      | kg     | 700    |                                |                               |
| 7   | Astar antikorroziv          | kg     | 400    |                                |                               |
| 8   | Boje betony                 | kg     | 500    |                                |                               |
| 9   | Boje per siperfaqe sportive | kg     | 1,400  |                                |                               |

|    |                                              |       |        |  |  |
|----|----------------------------------------------|-------|--------|--|--|
| 10 | Boje bikomponente vijezi                     | kg    | 150    |  |  |
| 11 | Astar per dysHEME dhe beton                  | kg    | 400    |  |  |
| 12 | Llak per parket druri                        | litra | 200    |  |  |
| 13 | Astar per parket druri sportiv               | litra | 200    |  |  |
| 14 | Boje kundra mykut                            | kg    | 2,000  |  |  |
| 15 | Boje aerosol per piktura murale              | litra | 1,000  |  |  |
| 16 | Pigmente per ngjyrosje                       | kg    | 1,200  |  |  |
| 17 | Stuko Patinimi                               | kg    | 6,300  |  |  |
| 18 | Llac I gatshem                               | kg    | 12,000 |  |  |
| 19 | Hidroizolues                                 | kg    | 2,350  |  |  |
| 20 | Tretes ( hollues ) dylent nitro              | litra | 750    |  |  |
| 21 | Rula standart komplet per lysterje           | cope  | 600    |  |  |
| 22 | Rula te vegjel komplet per lysterje          | cope  | 300    |  |  |
| 23 | Mbajttese boje per rula te vegjel            | cope  | 40     |  |  |
| 24 | Zgjatues (kodar) 3 metra                     | cope  | 140    |  |  |
| 25 | Zgjatues (kodar) 5 metra                     | cope  | 90     |  |  |
| 26 | Furce per lysterje me kend                   | cope  | 300    |  |  |
| 27 | Furce per lysterje                           | cope  | 300    |  |  |
| 28 | Furce e madhe per lysterje                   | cope  | 150    |  |  |
| 29 | Spatola patinimi te medha                    | cope  | 70     |  |  |
| 30 | Spatola patinimi te vogla                    | cope  | 70     |  |  |
| 31 | Shirit ngjites maskimi ( tenie )             | cope  | 1,200  |  |  |
| 32 | Qese mbulimi                                 | cope  | 900    |  |  |
| 33 | Koka sprucimi per aerosol                    | set   | 450    |  |  |
| 34 | Penel per piktura murale 76 mm               | cope  | 80     |  |  |
| 35 | Penel per piktura murale 36 mm               | cope  | 80     |  |  |
| 36 | Penel per piktura murale 16 mm               | cope  | 150    |  |  |
| 37 | Penel per piktura murale 14 mm               | cope  | 150    |  |  |
| 38 | Penel per piktura murale 12 mm               | cope  | 150    |  |  |
| 39 | Penel per piktura murale 10 mm               | cope  | 150    |  |  |
| 40 | Shenjues per grafite 20 mm                   | cope  | 120    |  |  |
| 41 | Shenjues per grafite 8 mm                    | cope  | 120    |  |  |
| 42 | Rimbushes per shenjuesit e grafiteve 2500 ml | cope  | 100    |  |  |
|    | <b>Vlera totale pa TVSH</b>                  |       |        |  |  |
|    | <b>Vlera TVSH 20%</b>                        |       |        |  |  |
|    | <b>Vlera totale me TVSH</b>                  |       |        |  |  |

#### Afatet e l vrimitt:

Afati i levrimitt te mallra do te jete 12 muaj nga nenshkrimi i Marreveshjes Kuader, sipas nevojave te Autoritetit Kontraktor, i cili do te njoftoje krahas  do minikontrate q  do t  lidhet n  zbatim dhe brenda afatit t  kesaj marr veshje.

---

## Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

##### OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

---

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**2.1.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

---

**2.1.2** Organi i vlerësimit të konformitetit të çertifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues duhet të jetë i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

**2.1.3** Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë çertifikatat ISO të kërkuara janë të detyrueshme për secilin operator ekonomik, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**2.2.2** Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të jetë jo më e ulët se vlera e fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2025 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar). Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur një deklaratë për shlyerjen e detyrimeve vendore ose vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, deklaratën ose vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

*Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 40% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë;

